REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 111/17
Datë/Datum. 05-05-2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit: **"Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Klinika e Syve"**	Kopje:	Paneli Shqyrtues – **OSHP Nr. 111/17.**
Nga:	Sofije Saramati - Eksperte shqyrtues		
Lënda:	Ekspertiza për lëndën **"Furnizim me material për shtyp"**, me nr. të Prokurimit: 701-16-109-121		
Përgjigjeje në ankesë:	**OE, NTG "Blendi" - Prishtinë**		
Datë			**05.05.2017**

Bazuar në nenin 114 të LPP-së ju njoftojmë me Raportin e ekspertizës, lidhur me Ankesën e parashtruar nga OE: **OE, NTG "Blendi" - Prishtinë,** kundër AK – **"Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Klinika e Syve",** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizim me material për shtyp",** me nr. të Prokurimit: **701-16-109-121.**

AK, është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

1x1 Panelit Shqyrtues të OSHP-së.
1x1 Autoriteti Kontraktues.
1x1 Operatorit ekonomik ankues.

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		25.04.2017		26.04.2017		05.05.2016
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën **04.04.2017**, OSHP, ka pranuar ankesën me nr. **111/17,** e parashtruar nga OE: **NTG "Blendi" - Prishtinë**, kundër AK – **"Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Klinika e Syve",** lidhur me aktivitetin të prokurimit **"Furnizim me material për shtyp",** -me nr. të Prokurimit: **701-16-109-121.**

Konform nenit 113.1, te LPP-se Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – **Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Klinika e Syve**

N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues NTG "Blendi" – Prishtinë.

Pikat e Ankesës nga OE **NTG "Blendi" – Prishtinë.**

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:

Qendra Klinike Universitare e Kosovë, në tekstin e mëtutjeshëm (Autoriteti Kontraktues), për këtë tender (Furnizim me material për shtyp), sipas kompanisë "Blendi" nga Prishtina. ka bërë shkelje ligjore të dispozitave të Ligjit Nr. 05/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237 (LPP).

Autoriteti Kontraktues- Departamenti i Prokurimit ka bërë shkelje të dispozitave të LPP si në vazhdim :

Neni 7 i LPP (Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi),

Neni 59 i LPP (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve),

Neni 60 i LPP (Kriteret për Dhënien e Kontratës).

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Në vazhdim Ju prezantojmë faktet dhe argumentet, për gabimet dhe shkeljet e Autoritetit Kontraktues për tenderin "Furnizim me material për shtyp", të udhëhequr nga Departamenti i Prokurimit, të cilat Organi Shqyrtues i Prokurimit duhet ti merr parasysh.

Në vazhdim Ju prezantojmë Pikat e ankesës nga ana jonë, për shkeljet e Autoritetit Kontraktues- të udhëhequr nga Departamenti i Prokurimit, për tenderin "Furnizim me material për shtyp", duke na eliminuar neve (kompania "Blendi") pa të drejtë, duke e shpallur fitues tenderuesin "Office 1 Kosova" nga Prishtina edhe pse nuk i ka plotësuar kërkesat lidhur me aftësitë teknike dhe/ose profesionale, të cilat Organi Shqyrtues i Prokurimit duhet ti merr parasysh në shpjegimin dhe arsyetimin në vijim:

o Autoritetit Kontraktues, ka shkelur nenin 7 i Ligjit të Prokurimit Publik - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, sepse duke e shpallur tenderuesin e papërgjegjshëm "Office 1. Kosova" fitues, na ka trajtuar të pabarabartë dhe na ka diskriminua me këtë veprim, sepse kompania "Blendi" ka ofruar tenderin e përgjegjshëm me Çmimin me te ulët sipas radhitjes së ofertave nga Proces verbali i hapjes prej 68,150.00 €.

o Kompania "Blendi" pas marrjes së njoftimit nga AK për tenderuesin e eliminuar, ka kërkuar qasje në dokumentacion për këtë tender dhe AK na ka mundësuar qasjen e duhur, gjë për te cilën e kemi falënderuar me shkrim. Me rastin e qasjes në dokumentacionin e tenderuesit fitues "Office 1 Kosova" kemi konstatuar se Autoritetit Kontraktues ka shkelur nenin 59 i Ligjit të Prokurimit Publik - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, dhe neni 41 i Rregullave dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik në Kosovë, ku Autoriteti Kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, por "Office 1. Kosova" nuk i ka plotësua të gjitha kërkesat.

O "Office 1. Kosova" nga Prishtina, nuk ka dorëzuar dëshmi si është kërkuar në Dosjes së tenderit, Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara:

Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT) paragrafi 3.1 te Specifikacionet teknike të detyrueshme Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë: Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit.

S. S

O "Office 1 Kosova" nga Prishtina, nuk ka dorëzuar dëshmi si është kërkuar në

Dosjes së tenderit:

Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT) paragrafi 9.1 te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Kërkesa 1: Operatori ekonomik ofertues duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses se paku tri kontrata te natyrës se njëjte përgjatë tri viteve te fundit 2013, 2014,2015.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Evidenca 1: Operatori Ekonomik ofertues duhet qe te ofroj një liste te kontratave, minimum 3 te realizuara gjatë 3 viteve të fundit: 2013,2014,2015, të përcjellura me referenca.

Me rastin e qasjes në dokumentacionin e tenderuesit fitues "Office 1 Kosova", gjatë kontrollimit të dokumentacionit të tenderuesit fitues, kemi gjetur të bashkangjitur vetëm një referencë valide (kurse është kërkuar referenca për së paku 3 kontrata) nga Lista e prezantuar e furnizimeve kryesore, të realizuar gjatë 3 viteve të fundit, dmth. për material shtypi, kurse të tjerat referenca për veç që nuk janë të njëjta por janë për ë furnizime me material zyrtar, administrativ, nuk janë në pajtueshmëri me kërkesën numër 1, që Operatori ekonomik ofertues duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses se paku tri kontrata te natyrës se njëjtë përgjatë tri viteve te fundit 2013,2014,2015.

Në vijim do t`i theksojmë te gjitha referencat e tjera jovalide me të cilat "Office 1. Kosova" pa të drejtë është shpallur e përgjegjshme, te cilat Autoriteti Kontraktues i ka nënvizuar me marker të verdhë, ne i kemi marr kopje me datë 13.04.2017 nga znj.Dermaku me rastin e qasjes në dokumente dhe i kemi të fotokopjuara- Shtojcë: Referencat.

1. Referenca me nr. Rendor 3, nga Lista e Furnizimeve kryesore, nga KK DRAGASH "Furnizim me material administrativ dhe tonerë", me numër të prokurimit 621/12/41/121, për veç që nuk është kontratë e natyrës se njëjte, është e vitit 2012, qe bie ndesh me kërkesën e lartë shënuar nr. 1 te Dosjes se Tenderit - tri viteve te fundit 2013,2014.2015.

2. Referenca me nr. Rendor 13, nga Lista e Furnizimeve kryesore nga Qendra e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrimin në Bashkësi-Prizren, "Furnizim me material hargjues administrativ", me numër të prokurimit 71204/14/007/136, nuk është kontratë e natyrës se njëjte është e vetmja referencë që mund të merret si Valide në pajtueshmëri me kërkesën e lartë shënuar nr. 1 te Dosjes se Tenderit - tri viteve te fundit 2013,2014.2015.

3. Referenca me nr. Rendor 15, nga Lista e Furnizimeve kryesore per ISDY - Prizren, është një

S.S

Referencë (Material Zyrtar/letër/tonerë) pa titull, pa numër dhe datë se për cilën kontratë është dhënë. Në këtë referencë të bashkangjitur shkruan - citojmë. Me ane te kësaj letër Reference , zyra e ISDY-se dëshiroj qe ta përgëzoj kompanie ne fjale për efikasitetin e tyre ne punën e tyre profesionale ne bashkëpunim me ISDY-n qe nga viti 2012, KURSE, kontrata e bashkangjitur ne mes ISDY dhe Office 1 Kosova është me date: 26.09.2014 dhe nuk është kontratë e natyrës se njëjte, dhe nuk ka të bëjë me këtë referencë të bashkangjitur pasi qe nuk perputhen vitet midis kontrates dhe references, qe bie ndesh me kërkesën e lartë shënuar nr. 1 te Dosjes se Tenderit.

4. Referenca me nr. Rendor 21, nga Lista e Furnizimeve kryesore nga Qendra e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrimin në Bashkësi-Prizren, "Shtypja e broshurave dhe kartelave", me numër të prokurimit 71204/16/005/247 eshte e vitit 2016, qe bie ndesh me kërkesën e lartë shënuar nr. 1 te Dosjes se Tenderit - tri viteve te fundit 2013,2014.2015.

o Kurse arsyet që Autoriteti Kontraktues e ka eliminuar kompaninë "Blendi", citomë : Neni 130 i LPP-së, e sanksionon bashkëpunimin e ofërtuesve konkurrent, e qe ne rastin konkret bashkëpunimi ndërmjet OE Grafo-Loni, OE Nord, dhe OE Blendi, është evident, bazuar ne gabimet ne plotësimin e Formularit te paraqitjes se tenderit, ku nuk është cekur se kujt i dedikohet oferta si dhe titulli i prokurimit etj, nuk qëndrojnë.

Pretendimi i Autoritetit Kontraktues, se OE Grafo-Loni, OE Nord, dhe OE Blendi, kemi bashkëpunuar për konkurrim është paragjykim dhe i qëllimshëm, me te vetmen arsye qe te shpërblehet me kontrate "Office 1. Kosova".

NTG BLENDI e ka biznesin e regjistruar ne ARBK konform ligjeve ne fuqi ne vendin tone. Pra, nuk kemi bashkëpunim në këtë aktivitet me asnjërin nga OE, por jemi thjeshte konkurrent ndaj njëri tjetrit.

Eliminimi i kompanisë sonë me arsyetimin se kemi shkelur nenin 130 te LPP, është i pa argumentuar nga AK, pa asnjë baze ligjor por i bazuar ne paragjykime, sigurimin e ofertës sonë është origjinal dhe është ne përputhje te plote kërkesën e DT dhe LPP.

o Edhe Formulari i tenderit është i plotësuar dhe i nënshkruar si duhet, sepse pjesa

e pa plotësuar te :

Për: Ishëno emrin dhe adresën e Autoritetit Kontraktuesi, (në tej "Autoriteti Kontrakt

Titulli i Kontratës: Ishëno Titullin),është pjesë që e plotëson Autoriteti Kontraktues në të shumtën e rasteve dhe janë të plotësuara në "Header"

Numri i Prokurimit: 701-16-109-121 - Titulli: Furnizim me material për shtyp,

S.S

pra dihet për cilin aktivitet të prokurimit ofertohet, dhe kujt i drejtohet e qe eshte leshim teknik-devijim i vogël qe nuk e ndryshon as nuk e demton asgjë aktivitetin e prokurimit, thjeshte është devijim jo material i cili pranohet dhe lejohet me nenin 59.4 te LPP.

o Është shkelur neni 60 i Ligjit të Prokurimit Publik- Kriteret për Dhënien e

Kontratës, përkatësisht Dosja e tenderit Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), Kriteret e Dhënies pika 31.1 Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka

dorëzuar : tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

Këtu Autoriteti Kontraktues, nuk e ka respektuar kriterin e dhënë për të na shpallur neve fitues, sepse kemi dorëzuar tender të përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Pas këtyre argumenteve të prezantuara për parregullsitë dhe shkeljet e cekura nëpërmjet kësaj ankese, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, ta aprovoj ankesën tonë, të marr vendim mbi anulimin e njoftimit mbi dhënien e kontratës dhe aktiviteti i prokurimi për tenderin "Furnizim me material për shtyp", të kthehet në RIVLERESIM.

Demi Material

Dëmet materiale janë në angazhimin e personelit për përgatitjen e dokumentacionit dhe dosjes së tenderit dhe ekspertit për përgatitjen e Kërkesë për Rishqyrtim dhe Ankesës për OSHP.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP :	23.03.2017
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	Shërbime/ vlerë e mesme
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave, pas szgjatjes se afatit,	04.01.2017
Afati i parapare per hapje te ofertave, pas zgjatjes,	04.01.2017
Data e njoftimit per dhenje te kontrtes	04.11.2016

S.S

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatoret ekonomik	Vendi	Çmimi total për njësi €	Vërejtje
1.	"Printing press"	Prishtinë	49.672.20	JO
2.	"Europrinty"	Fushë Kosovë	77.831.00	JO
3.	"Dukagjini"	Pejë	99.959.216	JO
4.	"Blendi"	Prishtinë	68.150.00	JO
5.	"Grafo Loni"	Prishtinë	43.699.50	JO
6.	"Nord"	Prishtinë	36.408.80	JO
7.	"Litografia"	Gjakovë	39.889.70	JO
8.	"Office Kosova"	Prizren	64.030.00	JO
9.	"Berati"	Prizren	42.715.65	JO
10.	"KGT"	Prishtinë	98.957.16	JO
11.	"Agimi DE"	Deçan	38.746.30	JO
12.	"Arf" shpk	Fushë Kosovë	69.770.00	JO

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve me datën: 25.10.2016, *konstatohet se në hapjen e ofertave ka marrë pjesë katërmbëdhjetë (8) përfaqësues të OE, ku është lexuar emri i operatorit ekonomik, vendi, çmimi dhe ndonjë vërejtje nëse është paraqitur. Procesverbali i hapjes është nënshkruar nga anëtarët e komisionit të hapjes pranë AK-së.*

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- - Kryetar i komisionit –Minavere Dermaku
- - Anëtar i komisionit - Shqipe Jashari
- - Anëtar i komisionit – Fehmi Havolli

Data e mbarimit të vlerësimit: 07.09.2016

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....07.09.2016

Raporti i komisionit vlerësues:

Komisioni vleresues propozon dhenjen e kontrates kompanise : RILINDA SHPK, i pergjegjeshem dhe me çmimin me t e ulet.

5.5

Analiza dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues - (N. 306)

Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Sqarimi 1.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se është e qëndrueshme arsyeja e eliminimit të OE ankues se i njëjti tek "Formulari i dorëzimit të tenderit- të gjitha kushtet e përcaktuara", pjesa I e formularit nuk e ka plotësuar "shëno emrin dhe adresën e Autoritet Kontratktues", pasiqë shihet se i njëjti nuk ka shënuar emrin e AK- QKUK sipas kërkesës në formualirn e lartcekur.

Sqarimi 2.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk ak ofruar dëshmi si është kërkuar në dosje të tenderit ***Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara*** është i qëndrueshëm për faktin se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato tyë përmendura në aneksin I të dosjes së tenderit.

Sqarimi 3.

Lidhur me pretendimin ankimor se OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka ofruar tri referenca të natyrës së njëjtë, ekspertja sqaron se OE i rekomanduar i ka ofruar kontratat dhe referencat për vitet 2013, 2014, 2015, të natyrës së ngjashme, sic janë përshkruar më poshtë:

1. "Furnizim me material për zyrën tonë, material shtypu, toner si dhe të gjitha paisjet e nevojshmepër një zyrë funksionale për të vepruar në kuadër të punës"
2. Furnizim me tonera Zyren e Prokurimit Dragash 04.06.2013;
3. Furnizim me material Harxhues per zyre "Policia e Kosoves 05.06.2013;
4. Furnizim me matrijal administrativ për nevojat e QKMF-së KK.Prizren 22.09.2015 , që janë kontrata të natyres se ngjashme .

Prandaj OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar kërkesën e AK-së që të ofrohen tri kontrata me referenca të nartyrës së njëjtë.

S.S

Sqarimi 3.

Lidhur me arsyen e eliminimit te OE ankes se OE "Graf Lon ", Blendi dhe OE " Nord" kan marrëveshje për ofertim, ekspertja shqyrtuese sqaron se nuk ka mundesi të vërtetojë ketë fakt, prandaj mendon se ky pretendim duhet të sqarohet dhe të vërtetohet në MPB sipas Nenit 130 te LPP-së dhe se autoriteti kontraktues duhet të njoftojë MPB në lidhje me këto dyshime.

Mendimi i ekspertit:

Eksperti shqyrtues, bazuar në sqarimet e cekura në raport mendojn që Autoriteti Kontraktues – **Qendra Klinike Universitare e Kosovës** ''për aktivitetin e prokurimit: "**Furnizim me material për shtyp**", me nr. të Prokurimit: 701-16-109-121, nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së.

Prandaj eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që të anuloj vendimin e AK-së, njoftimin për dhënje të kontratës dhe lënda të kthehet në **RIVLERESIM**. ndërsa ankesa e OE ankues te aprovohet si pjeserisht e bazuar.

S.S